



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 135/5 Prot

Tiranë, më 09.05.2022

**V E N D I M**

Nr. 63, datë 09.05.2022

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të dhënies së masës disiplinore “vërejtje” dhe vlerësimin negativ për 6-mujorin e dytë të vitit 2021, të nëpunëses \*\*\*\*\*.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

**Vërej se:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr.135 prot., datë 2.2.2022, parashtruar prej nëpunëses \*\*\*\*\* , janë ngritur pretendime për shkelje të rënda dhe të përsëritura të kryera ndaj saj, nga eprori direkt, Drejtori i Administrimit të Pronës Shtetërore, në Ministrinë e Financave, të cilat kanë të bëjnë: së pari, me masën disiplinore “Vërejtje”, e cila i është dhënë duke mos patur asnjë provë ndaj saj dhe së dyti, me vlerësimin për 6-mujorin e dytë të vitit 2021 në nivelin 4, i cili është në kundërshtim me ligjin në kushtet kur nuk janë planifikuar detyra dhe objektiva për matjen e performancës në punë.

Me këto pretendime, të cilat i ka paraqitur në formën e denoncimit, nëpunësja në fjalë, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke kërkuar verifikimin dhe vlerësimin e shkeljeve të pretenduara ndaj

eprorit direkt, si dhe për t'i garantuar të drejtat që legjislacioni i shërbimit civil i garanton nëpunësit në një procedurë disiplinore dhe për një vlerësim objektiv të rezultateve në punë.

Për verifikimin e ligjshmërisë së pretendimeve të kërkueses dhe veprimeve të kryera, Komisioneri i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.135/2, datë 24.2.2022, i cili nëpërmjet shkresës me nr. 3735/3, datë 10.3.2022, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 135/3, datë 15.3.2022, ka dërguar gjithë dokumentacionin që materializon procedurën e dhënies së masës disiplinore, si dhe formularët e vlerësimit të punës për nëpunësen në fjalë.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së materialeve të mësipërme, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur kërkesës, rezulton se \*\*\*\*\*, është nëpunëse civile, në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Qirave dhe Monitorimit të Kontratave”, në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Shtetërore, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Me Vendimin nr. 15999/3, datë 8.10.2021, të eprorit direkt, ndaj saj është marrë masa disiplinore “Vërejtje”, për moszbatimin e detyrave konkrete që i janë ngarkuar nga eprori, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, për realizimin e planit të punës të drejtorisë.

Duke mos qenë dakord me masën disiplinore, nëpunësja në fjalë, në kërkesën e saj, bën me dije se, kjo masë, është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në bazë të së drejtës që i njej nëpunësit civil neni 41, pika 3, e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e konfirmuar edhe nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit.

Në këto kushte, nisur nga parimi i përcaktuar në nenin 36, të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, sipas të cilit, *asnjë institucion tjetër nuk mund të trajtojë çështje të cilat janë duke u trajtuar nga sistemi gjyqësor*, masa disiplinore, në këtë rast, nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit nga Komisioneri, pasi do të marrë zgjidhje përfundimtare nga gjykata. (Të njejtin qëndrim ka mbajtur edhe DAP në shkresën kthim përgjigje kthyer kërkueses dhe dërguar për dijeni Komisionerit, me nr. 708/1, datë 21.2.2022).

Në lidhje me pretendimet e ngritura për vlerësimin e rezultateve në punë, rezulton se në kuadër të procesit të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave, si dhe aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, bazuar në nenin 62, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” i ndryshuar, eprori direkt i nëpunëses në fjalë, konkretisht, Drejtori i Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore (\*\*\*\*\*), në cilësinë e Zyrtarit Raportues, ka kryer vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësen \*\*\*\*\*, për periudhën Korrik-Dhjetor 2021, duke e vlerësuar në nivelin 4 (jokënaqshëm).

Me këtë vlerësim, nëpunësja në fjalë, nuk ka qenë dakord, prandaj ka ushtruar të drejtën e ankimit, nëpërmjet shkresës nr. 607/9 prot., datë 26.1.2022, drejtuar Sekretarit të

Përgjithshëm të institucionit, në cilësinë e *Zyrtarit Autorizues*, duke kërkuar një shqyrtim të vlerësimit nga ana e tij. Në zbatim të pikës 2, Kreu V, të VKM nr.109, datë 26.2.2014, Sekretari i Përgjithshëm, pasi ka shqyrtuar ankimin, ka bërë rivlerësimin e tij në ndarjen DH, të formularit të vlerësimit: “*Rivlerësimi nga zyrtari autorizues*”, ku është shprehur dakord me vlerësimin e eprorit direkt, duke argumentuar arsyet se pse ai është dakord me këtë vlerësim. Argumentat e paraqitura nga *Zyrtari Autorizues* në këtë rast, kanë të bëjnë me mospërbushjen e detyrave funksionale nga ana e nëpunëses; mosrealizimin në kohë të detyrave; refuzimin në mënyrë periodike për raportimin dhe përcjelljen e informacionit tek eprori direkt dhe Sekretari i Përgjithshëm; si dhe me sjelljen jo të rregullt etike me kolegët dhe eprorët.

Pasi ka marrë edhe vlerësimin nga Sekretari i Përgjithshëm, nëpunësja, nëpërmjet shënimeve në formularin e vlerësimit, ka deklaruar se nuk është dakord me vlerësimin e 6-mujorit të dytë të vitit 2021, dhe se do ta ankimojë atë në rrugë gjyqësore. Gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës nga Komisioneri, njësia e burimeve njerëzore të institucionit sqaroi se, vlerësimi nuk është ankimuar në gjykatë.

Bazuar në përcaktimet e pikës 1, të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që realizohet çdo 6 muaj, i cili, referuar Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, kreu IV, për nëpunësit e kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nga këqyrja e formularit të vlerësimit për periudhën Korrik-Dhjetor 2021, në rastin konkret, vërehet se, ai është i rregullt nga pikëpamja formale, i nënshkruar nga personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji për kryerjen e procedurës së vlerësimit (*zyrtari raportues dhe zyrtari autorizues, i cili në rastin konkret paraqitet edhe si kundërfirmues, pasi pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm është vend i lirë*). Ndarja e roleve dhe përgjegjësi në këtë rast, shërben si një mekanizëm për garantimin e të drejtave të nëpunësit civil, për kryerjen e një vlerësimi sa më objektiv dhe garantimin e të drejtës së ankimit dhe rishqyrtimit të vlerësimit, siç ka ndodhur në rastin konkret, ku nëpunësja nuk ka qenë dakord me vlerësimin e dhënë nga eprori direkt.

Më tej, duke analizuar përmbajtjen e formularit të vlerësimit të rezultateve të punës, dhe konkretisht, ndarjen C, ku janë përcaktuar objektivat për periudhën e vlerësimit, konstatohet se, për punonjësen \*\*\*\*\*, në të gjitha objektivat, eprori direkt, ka vlerësuar në nivelin 4 (*jokënaqshëm*). Lidhur me këtë fakt, nëpunësja në fjalë, ngre pretendimin se, objektivat e punës për të cilat është vlerësuar, nuk i janë përcaktuar dhe planifikuar më parë nga eprori direkt, i cili, sipas saj, nuk ka përbushur detyrat e tij funksionale.

Në vijim të analizës, në ndarjen C, të formularit të vlerësimit, përcaktohen objektivat në mënyrë të tillë që të tregojnë specifikisht se çfarë pune do të kryhet për përmbushjen e tyre, të jenë të matshëm dhe të pëcaktuar në terma kohorë, dhe mbi këtë bazë, bëhet edhe matja e performancës nga eprori direkt. Më tej, sipas pikës 5, të Kreut IV, të aktit të mësipërm nënligjor, objektivat përcaktohen duke patur parasysh përshkrimin e punës për pozicionin përkatës, si një akt i rëndësishëm, i cili, shërben ndër të tjera, edhe për vlerësimin e rezultateve në punë, pasi, të gjithë elementët që ai përmbledh, ndikojnë për të kontrolluar dhe për të vlerësuar performancën e punonjësit, (pika 13/c, Kreu IV, e VKM nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar). Kjo do të thotë që, objektivat në formularin e vlerësimit të kërkueses, janë të lidhura me detyrat kryesore dhe objektivat e pozicionit të punës që ajo kryen si *Përgjegjës i Sektorit të Qirave dhe Monitorimit të Kontratave*, të përcaktuara në përshkrimin e punës të këtij pozicioni, prandaj, është i padrejtë pretendimi se, ajo nuk është e njohur me objektivat e punës.

Nga ana tjetër, nga përmbajtja e akteve të administruara, rezulton se nëpunëses në fjalë, gjatë periudhës së vlerësimit i është tërhequr vëmendja vazhdimisht nga ana e eprorit direkt për mosrealizimin e detyrave konkrete, ç’ka është mbajtur parasysh dhe pasqyruar nga ana e tij në vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë në cilësinë e *Zyrtarit Raportues*. Pra, edhe në këtë këndvështrim, nuk mund të pretendohet se, nuk është e njohur me detyrat dhe objektivat e pozicionit të punës, kur në mënyrë të përsëritur, nëpunëses në fjalë, i është kërkuar përmbushja e tyre, për më tepër, që pozicioni i saj si *Përgjegjës i Sektorit*, lidhet jo vetëm me detyrat konkrete të saj, por edhe me drejtimin e vartësve dhe administrimin e punës si sektor.

Ndërkohë, nga këqyrja e mëtejshme e formularit të vlerësimit konstatohet se, rubrikat e këtij formulari janë të shoqëruara me komentet përkatëse në lidhje me vlerësimin, i cili, kryesisht është bërë në nivelin 4 dhe në pak raste, në nivelin 3. Pra, vlerësimi për çdo objektiv, si dhe në të gjitha ndarjet e formularit, është i arsyetuar dhe shoqëruar me argumentet përkatëse nga eprori direkt. Komente dhe argumentet e arsyetuara, janë bërë edhe nga Sekretari i Përgjithshëm në cilësinë e *zyrtarit autorizues*, pas rishqyrtimit të vlerësimit.

Gjithashtu, duhet thënë se, krahas plotësimit të formularit nga eprori direkt, një tregues tjetër i vlerësimit të sjelljes profesionale të kërkueses (në formular i përket *Ndarjes Ç*), i cili ka të bëjë me: *gabimet/saktësinë e punës së kryer; realizimin në kohë të punës; kolegjalitetin e marrëdhënieve; gatishmërinë për punën në grup* etj, janë pikërisht mosrealizimi i këtyre detyrave në mënyrë të përsëritur, si rrjedhojë e të cilave, i është dhënë edhe masa disiplinore “*Vërejtje*”.

Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në konkluzionin se, procedura e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik-Dhjetor 2021, për nëpunësen \*\*\*\*\*, është kryer sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013,

*“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, duke i siguruar asaj të drejtën e ankimit për shqyrtimin e vlerësimit nga *Zyrtari Autorizues* dhe rishqyrtimin e vlerësimit nga ana e tij me argumentet përkatëse. Për rrjedhojë, edhe pretendimet në lidhje me eprorin direkt nuk mund të merren parasysh, pasi, qëndrimet dhe veprimet e tij, janë në përmbushje të detyrave të tij funksionale, si dhe në zbatim të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ, të kryer për verifikimin e ligjshmërisë së shkeljeve të pretenduara ndaj eprorit direkt, nga nëpunësja \*\*\*\*\*\*, pasi veprimet e kryera gjënden në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nëpunësja \*\*\*\*\*\*, si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**